

VENDIM
Nr. 106, datë 27.2.2022

**PËR NDALIMIN E FLUTURIMEVE AJRORE NGA TRANSPORTUESIT
AJRORE RUSË NË HAPËSIRËN AJRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “ç”, dhe 9, pikat 1 e 7, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndalimin e fluturimeve ajrore, përfshirë çdo avion të operuar nga transportuesit ajrorë rusë, duke përfshirë si transportues marketingu në marrëveshjet e ndarjes së kodit ose të hapësirës së bllokuar, për çdo avion të regjistruar në Rusi dhe për çdo avion jo të regjistruar në Rusi, i cili është në pronësi ose me qira, ose kontrollohet ndryshe nga çdo person fizik ose juridik, ent ose organ rus, lejeve për të ulur, për t’u ngritur nga ose për të fluturuar mbi territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Organet përgjegjëse mund të autorizojnë një avion të ulet, të ngrihet ose të fluturojë mbi territorin e Republikës së Shqipërisë nëse autoritetet kompetente kanë përcaktuar se një ulje, ngritje ose fluturim i tillë kërkohet për qëllime humanitare ose për çdo qëllim tjetër, në përputhje me objektivat e këtij vendimi.

3. Organet përgjegjëse do të refuzojnë të gjitha planet e fluturimit të paraqitura nga operatorët e avionëve, që tregojnë një synim për të kryer aktivitete mbi territorin e Republikës së Shqipërisë, që përbëjnë shkelje të dispozitave të këtij vendimi ose të masave të tjera të sigurisë dhe sigurisë në fuqi, në mënyrë që piloti të mos lejohet të fluturojë.

4. Ky vendim do të jetë në fuqi deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/335, të datës 28 shkurt 2022, i cili ndryshon vendimin (CFSP) 2014/512, në lidhje me masat kufizuese, në përgjigje të veprimeve të Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë.

5. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama